

**BASHKIM BOSETA****ZGJEDHJET PËR ASAMBLENË KUSHTETUESE  
TË VITIT 1928\*****Zhvillimet kryesore politike në prag  
të shpalljes së zgjedhjeve**

Krijimi i Monarkisë Shqiptare, kaloi nëpërmjet një rruge të studiuar mirë. Si një politikan që kishte arritur shpejt postet më të larta drejtuese të shtetit, Zogu ishte i vetëdijshëm se ndryshimi i sistemit politik, duhej bërë sa të ishte e mundur, nëpërmjet hapësirave ligjore, proces të cilin mund ta definonte Asambleja Kushtetuese. Pasi siguroi mbështetjen italiane dhe të grupimeve të caktuara të shoqërisë shqiptare, vëmendja u përqendrua në krijimin e kushteve që do të mundësonin kalimin e vendit në zgjedhje të reja. Ato më të afërtat mund të bëheshin në pranverën e vitit 1929, dhe do të ishin për Dhomën e Deputetëve, pasi Statuti Themeltar i Republikës kishte përcaktuar se deputeti zgjidhej për katër vjet. Ndërsa ato për 2/3 e senatorëve, i takonte të bëheshin në vitin 1931, sepse ata zgjidheshin për 6 vjet.<sup>1</sup> Kështu që mundësi e vetme, ishte krijimi i situatave konfliktuale mes dhomave të parlamentit, me qëllim shpërndarjen e tyre. Si pretekst për këtë shërbeu projektligji për krijimin e Këshillit të Shtetit dhe pikërisht klauzola, se kush do të kishte të drejtën e emërimit të anëtarëve të tij. Në nëntor 1927, Dhoma e Deputetëve gjatë diskutimit të bërë, saktësoi në pikën 1 se, “Këshilli i Shtetit përbëhet prej pesë anëtarësh, të emëruar drejtpërdrejtë me dekret të Kryetarit të Republikës, nga të cilët njëri dekretohet kryetar”.<sup>2</sup>

Në mars të vitit 1928, Senati bëri shtesa në art. 1, duke saktësuar se, “emërimi i anëtarëve dhe kryetarit të Këshillit të Shtetit bëhet me vendimin e Këshillit Ministror dhe me dekretimin e Kryetarit të

---

\* Kumtesë e mbajtur në Konferencën shkencore “100 vjet zgjedhje në Shqipëri: prill 1921 - prill 2021”, organizuar nga Departamenti i Historisë së Pavarësisë dhe Konsolidimit të Shtetit Shqiptar dhe ai i Historisë Bashkëkohore në Institutin e Historisë pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike (ASA), Tiranë, 22 prill 2021.

<sup>1</sup> Statuti Themeltar i Republikës Shqiptare, art. 11, 49, Tiranë: Nikaj, 1925, f. 5, 15.

<sup>2</sup> Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) Parlamenti (146), Viti (më tej: V.) 1927, Dosja (më tej: D.) 95, fl. 110.

Republikës”.<sup>3</sup> Këto ndryshime u kundërshtuan nga deputetët me argumentin që, Këshilli i Shtetit ishte institucion i pavarur dhe duhej të qëndronte jashtë çdo ndikimi dhe Këshilli i Ministrave nuk mund të ishte përgjegjës për personat e institucioneve të pavarura, siç ishte Këshilli i Shtetit.<sup>4</sup> Pikërisht ky qëndrim i deputetëve, përgatiti kushtet për futjen e parlamentit në krizë institucionale, duke paraprirë një zhvillim, përfundimin e të cilit e dinin mirë, si deputetët, ashtu edhe senatorët. Kjo pasi në art. 56 të Statutit Themeltar thuhej se, nëse Dhoma e Deputetëve ndesh në kundërshtime me Senatin për ndonjë vendim apo ligj, dhe Dhoma insiston në mendimin e saj, Kryetari i Republikës ka të drejtë me pëlqimin e Senatit të shpërndajë Dhomën e Deputetëve.<sup>5</sup> Por edhe nëse do të ndodhte një gjë e tillë, nuk ishte garanci për përfundimin me sukses të procesit të paramenduar pasi, shpërndarja e Dhomës së Deputetëve, presupozonte shpalljen e zgjedhjeve të reja, por vetëm për këtë Dhomë. Pra, nuk do të krijohesh një institucion që mund të garantonte ndryshimet kushtetuese. Zhvillimet e mësipërme u pasqyruan edhe në organet e shtypit, madje duke parashikuar edhe përfundimin e tyre. “Gazeta e Korçës” në fillim të prillit 1928, shkruante se, sipas qarqeve politike të Tiranës, konflikti mes Senatit dhe Dhomës së Deputetëve mund të shkaktojë edhe shpërndarjen e parlamentit.<sup>6</sup>

Në kuadrin e ndryshimeve të programuara, Zogu kishte nevojë për mbështetjen dhe besnikërinë e të gjitha institucioneve shtetërore, ku rol të rëndësishëm kishte qeveria. Megjithëse Statuti i kishte dhënë pushtet të madh, ai u kujdes që procesin e realizimit të tyre, ta kontrollonte një qeveri besnike dhe e përkushtuar. Për ta paraqitur sa më natyrshëm largimin e qeverisë ekzistuese, u shkaktua një konflikt artificial midis anëtarëve të saj, gjatë diskutimit të projektligjit mbi punimin e rrugëve, i paraqitur para deputetëve, në fillim të majit 1928. Përplasja në këtë rast ndodhi mes ministrit të Punëve Botore Hilë Mosit, mbështetës i projektit dhe ministrit të Brendshëm Abdurrahman Dibrës<sup>7</sup>, gjë e cila u pasua me dorëheqjen e dy ministrave të mësipërm dhe pastaj të gjithë qeverisë. Nga një analizë e thjeshtë e këtij rasti, kuptohet qartazi se dorëheqja e kësaj qeverie ishte e inskenuar, pasi dy pjesëtarët e saj, autorë të konfliktit,

<sup>3</sup> *Po aty*, F. 146, V. 1928, D. 87, fl. 279.

<sup>4</sup> *Po aty*, fl. 284.

<sup>5</sup> *Statuti Themeltar i Republikës...*, art. 16-17.

<sup>6</sup> “Parlamenti mund të shpërndahet”, në *Gazeta e Korçës*, nr. 475, Korçë, 5 prill 1928, f. 1.

<sup>7</sup> *AQSH*, F. 146, V. 1928, D. 88, fl. 275-277.

kishin hapësirat e duhura ligjore dhe mundësinë për t'i konsumuar ndasitë dhe gjetur zgjidhje për kundërshtimet e tyre, përpara se projekti të shkonte në parlament. Më 11 maj 1928, kabineti i ri mori detyrën.<sup>8</sup>

Pas krijimit të qeverisë së re, vëmendja u rikthye te konflikti parlamentar, por nuk mund të rrezikohej vetëm me shpërndarjen e Dhomës së Deputetëve, e cila vazhdonte të insistonte në qëndrimin e saj. Në këtë rast, Senati u tregua më bashkëpunues, duke ofruar propozime të reja. Më 14 maj 1928, ai mori vendimin që të shtohet në Statut, një dispozitë për krijimin e Këshillit të Shtetit. Nëse kjo do të pëlqehet nga Dhoma e Deputetëve, atëherë duhet të mblidhet Asambleja Legjislative, sipas nenit 141 të Statutit.<sup>9</sup> Deputetët e anashkaluan kërkesën e Senatit, pasi më 21 maj 1928, 40 prej tyre paraqitën një propozim, me të cilin u bashkuan edhe disa ministra, ku kërkohet rishikimi i përgjithshëm i Statutit.<sup>10</sup> Përgjigjja e Senatit për propozimin e deputetëve vonoi, dhe kjo solli që ata t'i drejtohen Kryetarit të Republikës, për të mbledhur Asamblenë Legjislative.<sup>11</sup> Zhvillimet e shpejta parlamentare, përplasja mes dhomave, shmangia e mekanizmave ligjorë për t'i kaluar ato dhe dorëheqja e qeverisë, ngjallën diskutime dhe perceptime të ndryshme në opinionin publik të kohës, të cilat u pasqyruan edhe në organet e shtypit. Aty shkruhet se, Senati ishte kundër rishikimit të Statutit, ndërsa Dhoma e Deputetëve kërkonte rishikimin e plotë të tij dhe se ishte e çuditshme që, incidenti pa rëndësi i mosmarrëveshjes për krijimin e Këshillit të Shtetit, u rrit aq shumë, sa u bë i pakalueshëm midis dy dhomave. Në artikull theksohet se, kjo situatë ngjante me atë të qeverisë, ku një konflikt i tillë mes dy pjesëtarëve të kabinetit, solli rrëzimin e tij. Madje sipas gazetës, disa deputetë ishin aq të sigurt që Dhoma do të shpërndahej, sa që ishin gati “të merrnin pasaportat” dhe të largoheshin nga Tirana për të pritur zgjedhjet.<sup>12</sup>

Kërkesës së deputetëve, Zogu iu përgjigj më 2 qershor 1928, me anë të një mesazhi ku theksohet se, pas miratimit të buxhetit të shtetit Dhomat do të mblidheshin në një sesion të jashtëzakonshëm, për të

<sup>8</sup> Joseph Swire, *Shqipëria - Ngritja e një mbretërie*, Tiranë: Dituria, 2005, f. 406.

<sup>9</sup> *AQSH*, F. 146, V. 1928, D. 89, fl. 415.

<sup>10</sup> *Po aty*, fl. 518.

<sup>11</sup> *Po aty*, F. 146, V. 1928, D. 90, fl. 262.

<sup>12</sup> “Konflikti midis Senatit dhe Dhomës po vazhdon”, *Telegraf*, nr. 122/21, Tiranë, 1 qershor 1928, f. 1.

diskutuar rishikimin e Statutit.<sup>13</sup> Ato u mblodhën më 7 qershor dhe vendosën që të bëhej një shtojcë në art. 141, duke sanksionuar që, “Rishikimi i përgjithshëm i Statutit, i përket vetëm Asambles Kushtetuese. Kur vendoset nevoja e rishikimit të përgjithshëm të Statutit si mbas procedurës së caktuar në këtë artikull, të dy Dhomat quhen vetiu të shpërndara dhe dekretohen zgjedhje për Asamblenë Kushtetuese”.<sup>14</sup> Më 16 qershor 1928, A. Zogu firmosi dekretin mbi zgjedhjet për Asamblenë Kushtetuese. Votimi do të kryhej sipas ligjit për zgjedhjen e deputetëve të marsit 1925. Zgjedhësit e parë do të fillonin votimin prej datës 16 korrik 1928. Zgjedhësit e dytë do të votonin për zgjedhjen e anëtarëve të Asamblesë Kushtetuese më 16 gusht 1928. Ajo do të mblidhej ditën e shtunë, më 25 gusht 1928.<sup>15</sup>

### Organizimi i procesit zgjedhor

Pasi u krijuan hapësirat e nevojshme ligjore dhe u mor vendimi për shpërndarjen e parlamentit, rëndësi e posaçme iu kushtua procesit të organizimit të zgjedhjeve për Asamblenë Kushtetuese. Për sigurimin e një rezultati sa më të mirë të mbështetësve të Zogut, u punua njëkohësisht në planin e brendshëm dhe të jashtëm. Paralel me procedurat e zhvillimit të procesit zgjedhor, ku siç do të rezultojë u përfshi e gjithë administrata shtetërore, ishte edhe qëndrimi i shtypit brenda vendit. Në planin e jashtëm, me shtetin italian u arrit sigurimi i një mbështetjeje financiare, gjë e cila u realizua në kuadrin e disa marrëveshjeve dhe lëshimeve të bëra nga A. Zogu për palën italiane.

Në funksion të fitores së kandidatëve qeveritarë, rëndësi e posaçme iu kushtua koordinimit të punës dhe veprimtarisë së institucioneve qendrore dhe lokale. Ministria e Brendshme mori rolin kontrollues në këtë drejtim, fillimisht nëpërmjet urdhrave të veçantë, për zona të caktuara, duke kaluar pastaj, në urdhra të përgjithshëm, për të gjitha institucionet lokale në vend. Në një qarkore për prefekturën e Vlorës, më 28 qershor 1928, pasi bëhej e ditur se drejtues i bashkisë ishte emëruar Arshi Halili, udhëzohej për bashkëpunim të ngushtë me të, në mënyrë që

<sup>13</sup> AQSH, F. 146, V. 1928, D. 90, fl. 325.

<sup>14</sup> *Shqipëria më 1937, Veprimi shtetnor gjat njëzet e pesë vjetëve të parë të vetqeverimit 1912-1937*, vëll. I, Tiranë: Kristo Luarasi, 1937, f. 62.

<sup>15</sup> “Dekret mbi zgjedhjen e misavet t’Asambles Kushtetuese”, në *Fletorja Zyrtare*, nr. 64, Tiranë, 16 qershor 1928, f. 1.

të merrej garancia që zgjedhësit e dytë të ishin besnikë të regjimit dhe votën e tyre, ta jepnin pa më të voglin dyshim dhe pa bërë intriga, për kandidatët e listës qeveritare. Po aty theksohej, që në rast nevojë prefektura të merrte të gjitha masat e duhura ligjore, që votimi të ishte patjetër pro listës qeveritare.<sup>16</sup> Në përgjigjen e dhënë të nesërmen, prefekti i Vlorës Qazim Bodinaku, paraqiste një situatë jo të qetë në prefekturë, pasi sipas tij, parashikohej një luftë e ashpër politike, sepse kundërshtarët po përgatisnin sheshin dhe do të bënin çdo sakrificë për t'ia arritur qëllimit. Për të përballuar problematika që mund të vinin nga këto zhvillime, ai kërkoi dërgimin e 20 xhandarëve dhe drejtoria vendore e financave të urdhërohej të bënte publikë, emrat e të gjithë personave që nuk kishin shlyer detyrimet për të gjitha llojet e taksave, duke kërkuar edhe burgosjen e tyre. Gjithashtu shihej e nevojshme edhe dhënie financimesh nga fondi sekret, për të përballuar shpenzimet për persona të veçantë, të cilët do të merreshin me kontrollin e veprimtarisë së kundërshtarëve.<sup>17</sup> Raportime me problematika të tilla, filluan të vinin edhe nga pjesë të tjera të vendit. Për t'i paraprirë këtyre situatave dhe për të garantuar fitoren e kandidatëve qeveritarë, Ministria e Brendshme kaloi në urdhra të përbashkët për të gjitha institucionet lokale. Kështu, më 30 qershor 1928, në një qarkore drejtuar gjithë prefekturave, kërkohet, "qi në marrveshtje me njerzit besnikë të Qeveries, të perpiqeni energjikisht qi zgjedhsit e dytë qi do të zgjidhen për listat e Asambles të jen gjith pro-Qeveritare".<sup>18</sup> Nëse ndalemi pak këtu, vetëm urdhrat dhe komunikimet e mësipërme, janë të mjaftueshme për të dëshmuar se tashmë të gjitha institucionet shtetërore, do të ishin të angazhuara gjatë procesit zgjedhor, me detyra dhe objektiva të përcaktuara saktë, për të mbështetur dhe garantuar fitoren e kandidatëve qeveritarë.

Sipas ligjit të marsit 1925, mbi bazën e të cilit do të zhvilloheshin këto zgjedhje, kandidaturë mund të shpallte kushdo që plotësonte kriteret ligjore dhe duhej ta paraqiste atë në qarkun ku do të kandidonte, 15 ditë përpara datës së caktuar për zgjedhjen e anëtarëve të parlamentit. Kishin të drejtë të shpallnin kandidaturë edhe shqiptarë që jetonin jashtë. Por, përveç plotësimit të kriterëve ligjore, ata duhej të paguanin edhe 100 franga ari në zyrat financiare përkatëse në Shqipëri, ose pranë

<sup>16</sup> *AQSH*, F. Ministria e Punëve të Brendshme (152), V. 1928, D. 1/a, fl. 534.

<sup>17</sup> *Po aty*, F. 152, V. 1928, D. 1, fl. 14.

<sup>18</sup> *Po aty*, fl. 21.

konsullatave shqiptare, në vendet ku jetonin.<sup>19</sup> Kështu, në këto zgjedhje, pavarësisht se në masë të vogël, u paraqitën disa kandidatë që nuk kishin mbështetjen e institucioneve shtetërore qeveritare. Menjëherë organet lokale u vunë në lëvizje dhe dhanë informacione për ato qendrore, duke kërkuar edhe mendim për veprimet e mëtejshme që duheshin ndërmarrë. Prefekti i Beratit më 12 korrik 1928, njoftonte Ministrinë e Brendshme se konsullata e Konstancës, kishte shpallur si kandidaturë për në asamble në atë qark, dr. Zoi Xoxen. Nga ministria kërkoheshin udhëzime, nëse duhej lejuar shpallja e këtyre kandidaturave, përpara se të bëhej e njohur lista qeveritare. Përgjigjja e ardhur më 13 korrik ishte se ato mund të shpalleshin, por të mos i jepej asnjë përkrahje nga organet shtetërore.<sup>20</sup>

Në krijimin e hapësirave sado të vogla për shpalljen e kandidaturave të tilla luajti rol dhe shtypi i shkruar, bile edhe ai proqeveritar. Kuptohet që kjo ndodhi në kohën kur nuk kishte akoma informacion të saktë se, për çfarë do të shërbenin në të vërtetë këto zgjedhje, pra cili do të ishte qëllimi i tyre final. Kjo evidentohet nga përmbajtja e mesazheve që transmetoheshin në këto organe, pasi thirrja për kandidatë të tjerë jashtë listës qeveritare, bëhej njëkohësisht me promovimin e regjimit republikan. Në një shkrim të gazetës “Telegraf”, në fillim të korrikut 1928, shtrohej ideja se në zgjedhjet që do të zhvilloheshin, duhej të kishte edhe grupe të tjera kandidatësh, përveç atyre të listës qeveritare. Sigurisht që qeveria do të përpiqej të përkrahte kandidatët e saj, por kjo nuk do të thoshte se populli, i cili ishte sovrani i vetëm në republikë, nuk kishte të drejtë të zgjidhte kandidatë të tjerë. Aty theksohej se të gjithë njerëzit me karakter të mirë, të ndershëm dhe të papërlyer, nuk mund të përmbledheshin vetëm në listën e kandidatëve qeveritarë. Përkundrazi jashtë asaj liste, mund të gjendeshin njerëz të tjerë me cilësi të barabarta, ose edhe më të mirë nga lista qeveritare. Prandaj në çdo regjim republikan, duhej të formoheshin dhe grupe të tjera.<sup>21</sup>

Shumica e listës së kandidatëve qeveritarë përbëhej nga ministra, ish deputetë dhe ish senatorë, të provuar për bindje dhe besnikëri ndaj Zogut. Shumë shpejt ajo u plotësua dhe iu bë e njohur prefekturave. Në këtë rast nuk u harrua të theksohej fakti që, ndaj nëpunësve shtetërorë të cilët do të neglizhonin ose nuk do të realizonin detyrat e caktuara në funksion të

<sup>19</sup> “Ligjë për zgjedhjen e dhomës së Deputetvet”, në *Fletorja Zyrtare*, nr. 10, 14 mars 1925, f. 3.

<sup>20</sup> *AQSH*, F. 152, V. 1928, D. 1, fl. 57, 59.

<sup>21</sup> “A duhet të formohen grupe të tjerë?”, në *Telegraf*, nr. 132, Tiranë, 8 korrik 1928, f. 2.

procesit zgjedhor, do të kishte sanksione. Menjëherë pas kësaj më 28 korrik 1928, nga Ministria e Brendshme, doli një tjetër qarkore për të gjitha prefekturat e vendit. Ndër të tjera aty shkruhej se për çdo prefekturë, ishin caktuar personat që do të bënin pjesë në asamble. Prandaj duhej të merreshin të gjitha masat e nevojshme, që kandidatët e paraqitur sipas zonave të votoheshin në grup. Prefekturat duhej t'u jepnin udhëzime të sakta institucioneve të varësisë për realizimin me sukses të detyrave, duke iu kujtuar se çdo neglizhencë do të dënohej me masat më të rënda.<sup>22</sup> Ky ishte një tjetër zhvillim që tregonte ndërhyrjen shtetërore në këto zgjedhje për të siguruar fitoren e kandidatëve qeveritarë. Pikërisht urdhra të tillë na shërbejnë për të kuptuar se ky proces më tepër sesa një votim popullor, do të ishte një fasadë, pasi përpara fillimit të tij ishte përcaktuar se kush do të fitonte.

Pavarësisht se u paraqitën në numër të vogël, por për shkak të prejardhjes, kontributit në fusha të ndryshme, fuqisë ekonomike dhe mbështetjes publike që zotëronin, kandidatura ose grupime të tjera në zona të caktuara, mund të përbënin rrezik për fitoren e kandidatëve qeveritarë. Për të ndaluar ndonjë zhvillim të papritur, Ministria e Brendshme mori masa. Në këtë drejtim u veprua me zgjuarsi, pasi nga njëra anë, u synua promovimi në publik i një procesi gjithëpërfshirës, demokratik, i cili do të bënte të mundur zgjedhje të lira dhe konkurruese, dhe nga ana tjetër u punua që, fitorja e kandidatëve qeveritarë të ishte e sigurt. Me qarkore të posaçme u udhëzuan prefekturat që, pas marrjes së masave dhe sigurisë që votimi do të ishte plotësisht pro kandidatëve qeveritarë, të ftoheshin edhe kandidatë të tjerë për të shpallur kandidaturën e tyre, ose drejtpërdrejt, ose në emër të zgjedhësve të dytë. Por nëse do të ndodhte një gjë e tillë, menjëherë duheshin raportuar emrat e personave.<sup>23</sup> Kuptohet që pas kësaj do të fillonte kontrolli i tyre dhe i veprimtarisë që do të zhvillonin. Normalisht procesi i verifikimit të qartësisë së figurës së kandidatëve pjesëmarrës në zgjedhje, ishte i domosdoshëm dhe një detyrë që duhej kryer nga ana e institucioneve shtetërore. Por, nisur nga qarkorja e mësipërme mendojmë se qëllimi kryesor i verifikimit në këtë rast, ishte më tepër për t'u bindur, nëse personi ose personat në fjalë, mund të krijojnë probleme për kandidatët qeveritarë ose mund të kishin premisa për të fituar ndaj tyre. Nëse do të

<sup>22</sup> *AQSH*, F. 152, V. 1928, D. 1, fl. 97.

<sup>23</sup> *Po aty*, fl. 97, 107.

rezultonte një gjë e tillë, patjetër do të merreshin masa për t'i kufizuar, ose detyruar ata të tërhiqeshin nga gara.

Një aspekt tjetër që u trajtua me përparësi nga organet shtetërore, ishte mundësimi i një pjesëmarrjeje sa më të madhe popullore në këto zgjedhje. Kjo ishte e rëndësishme pasi ndryshimet e pritshme kushtetuese, do të paraqiteshin si një dëshirë dhe plotësim i vullnetit të popullit. Për këtë arsye, u dhanë urdhra të veçanta, për të detyruar njerëzit të dilnin në votime. Në funksion të kësaj dhe për sigurimin e një rezultati sa më të mirë në zgjedhje, u bënë përpjekje për plotësimin e kërkesave financiare të prefekturave dhe bashkive. Kryesisht këto shpenzime shkuan për shpërblime të drejtpërdrejta në këmbim të votës, darka dhe bankete të veçanta, sigurim ushqimi dhe strehimi për zgjedhësit e dytë, të cilët do të grumbulloheshin larg qendrave të tyre të banimit. Mbështetje financiare u dha edhe për mbikëqyrjen e personave që dyshoheshin, se mund të zhvillonin veprimtari kundër kandidatëve qeveritarë.<sup>24</sup>

Kërkesat financiare dhe mbështetja qeveritare për plotësimin e tyre, u shoqëruan shpejt me problematika që karakterizonin institucionet lokale, si mungesa e profesionalizmit, e korrektësisë, drejtimi paternalist dhe klima e mosbesimit në raportet midis tyre. Të gjitha këto evidentohen nga korrespondenca zyrtare e kohës. Kështu, nënprefektura e Mirditës më 8 gusht 1928, njoftonte se për të nxjerrë popullin në votime, ishte bërë propagandë, duke premtuar bakshishe, gjë e cila kishte sjellë pjesëmarrje më të madhe se asnjëherë tjetër dhe kishin rezultuar fitues të gjithë zgjedhësit e dytë, pro listës qeveritare. Prandaj për të shpërblyer besnikët ajo kërkonte 400 franga ari. Prefektura e Shkodrës nën varësinë e së cilës ishte kjo nënprefekturë, për këtë rast gjykonte të arsyeshme dhe të mjaftueshme shumë prej 100 franga ari, vetëm për të bërë një darkë për zgjedhësit e dytë dhe besnikët që kishin bërë propagandë. Kjo pasi, nënprefekturës në fjalë, edhe pse i ishte kërkuar disa herë të sillte emrat e atyre që do t'u shpërndaheshin bakshishet, nuk e kishte bërë, prandaj nuk dihej se ku do të shkonin këto të holla.<sup>25</sup>

Për shkak të traditës dhe zakoneve shekullore, një ndikim të madh mbi popullsinë, sidomos në zonat veriore të vendit kishin krerët e parive lokale. Drejtuesit e organeve vendore në mënyrë që të siguronin besnikërinë dhe mbështetjen e tyre për kandidatët qeveritarë, u kujdesen

<sup>24</sup> *Po aty*, fl. 24.

<sup>25</sup> *Po aty*, fl. 111.

që t'u bënin një trajtim sa më të mirë. Në raste të caktuara, për ta arritur këtë, u tejkaluuan edhe udhëzimet e ndryshme qeveritare. Madje drejtues të caktuar lokalë, kontribuuan në këtë drejtim edhe me financat e tyre. Shembulli konkret vinte nga nënprefektura e Pukës, e cila më 19 gusht 1928, njoftonte se për zgjedhësit e dytë që ishin mbledhur në qendër, ishte shtruar një drekë siç ishte vendosur përpara me Ministrinë e Brendshme. Po në atë drekë, ndonëse të paftuar, kishin ardhur pjesëtarë nga paria e maleve e kësaj nënprefekturie, afërsisht 100 vetë. Nga organet lokale, në shenjë gëzimi pasi ishte arritur fitorja e të gjithë zgjedhësve të dytë proqeveritarë, nuk ishte parë e arsyeshme që individët e mësipërm të përjashtoheshin nga pjesëmarrja në drekën e organizuar. Por, për të mbuluar shpenzimet e bëra, shuma prej 150 franga ari e dërguar nga ministria në dispozicion të kësaj dreke nuk kishte mjaftuar dhe nënprefekti nga të ardhurat e tij, kishte dhënë 67 franga. Pas këtij njoftimi ministria reagoi dhe më 24 gusht 1928, nisi me postë në drejtim të nënprefekturës 67 franga ari.<sup>26</sup>

Pavarësisht problematikave të shfaqura dhe ecurisë së raporteve, prefekturat, nënprefekturat dhe bashkitë luajtën rol të rëndësishëm në të gjitha aspektet e menaxhimit të procesit zgjedhor. Duke qenë në kontakte të përditshme me njerëzit e zakonshëm dhe duke njohur nga afër realitetin, në mënyrë që të arrihej një fitore e plotë e kandidatëve qeveritarë, drejtuesit e tyre dërgonin relacione të herëpashershme, ku kërkohej ndihma e institucioneve të larta shtetërore, për çështje të ndryshme. Një vëmendje e veçantë, iu kushtua informacioneve mbi propagandën që bëhej nga individë të caktuar dhe qëndrimin e tyre gjatë këtij procesi. Por reagimi i organeve qeveritare ndaj këtyre rasteve që i ndryshëm. Më 8 korrik 1928, nënprefektura e Lezhës njoftonte se kryetari i bashkisë Myrteza Bajaziti dhe Mano Begu, kishin nxjerrë njerëz për të bërë propagandë kundër kandidatëve qeveritarë. Kryetari ishte dhëndër i bejlerëve të Lezhës dhe kishte lidhje familjare me Riza Danin, Dan Hasanin dhe Maliq Bushatin. Sipas informacioneve ishte pikërisht ky i fundit që po e shtynte në këto veprime. Nga ministria kërkohej mendim për masat që duheshin ndërmarë. Në përgjigjen e ardhur theksohej që, personat e mësipërm duhej të porositeshin të ndalonin propagandën, pasi në rast vazhdimi, ndaj tyre do të merreshin masa administrative.<sup>27</sup>

<sup>26</sup> *Po aty*, fl. 211-212.

<sup>27</sup> *Po aty*, fl. 50, 52.

Interesant është fakti se në procesin zgjedhor, kryesisht në veri të vendit, u përfshinë dhe klerikë. Edhe në këto raste kontrolli i organeve qeveritare nuk mungoi, deri në kuptimin e saktë të qëllimeve të tyre. Më 26 korrik 1928, prefektura e Kosovës njoftonte se prifti i fshatit Dardhë të Pukës, dom Nikollë Deda, kishte dalë në Malësinë e Gjakovës për meshë, por në të vërtetë ishte duke bërë propagandë për zgjedhjet. Pavarësisht se njëhej si përkrahës i regjimit, kishte paqartësi për synimet e tij, prandaj kërkohej mendimi i ministrisë nëse duhej lënë i lirë në lëvizjet që po bënte. Në përgjigjen e ardhur të nesërmen theksohej se, ai ishte besnik i regjimit, prandaj të lihej i lirë të vazhdonte veprimtarinë në rrethin e Gjakovës.<sup>28</sup> Nëse analizojmë rastet e mësipërme, bie në sy qëndrimi me dy standarde i organeve shtetërore ndaj propagandës për zgjedhjet. Në rastin e parë reagimi ishte i shpejtë, duke kërkuar reflektim, ose marrje masash. Ndërsa në rastin e dytë, megjithëse ishte një klerik që duhej të merrej me punët e fesë dhe të qëndronte larg zgjedhjeve, jo vetëm nuk iu tërhoq vëmendja, por u lejua të vazhdonte në misionin e tij. Kuptohet se kjo u bë, pasi ai po ndihmonte në fushatën e kandidatëve qeveritarë. Pra në këtë rast, propaganda ishte e justifikueshme dhe u lejua nga organet shtetërore.

Rol të rëndësishëm në procesin zgjedhor kishin individët me detyra të veçanta si, ajo e qëndrimit në vendet e votimit, shoqërimit për aspekte të ndryshme gjatë zhvillimit të zgjedhjeve të personave të caktuar, numërimit të votave ose do të kujdeseshin për zgjedhësit e dytë. Në këtë drejtim u punua me përkushtim për sigurimin e personave të besueshëm dhe bashkëpunimi i organeve qendrore dhe lokale, qe produktiv. Nga këto të fundit, me synim forcimin e mëtejshëm të kontrollit shtetëror, u kërkuua disa herë marrja e masave, për mbajtjen larg nga menaxhimi i procesit zgjedhor në zona të caktuara, i personave me të kaluar të dyshimtë, që mund të përbënin rrezik për kandidatët qeveritarë.<sup>29</sup>

Vëmendja qeveritare u intensifikua edhe në kontrollin për zbatimin e urdhrave të dhënë, në funksion të procesit zgjedhor dhe marrjen e masave për moszbatimin e tyre. Në raste të tilla, bashkëpunimi midis institucioneve qendrore dhe atyre lokale, qe i shpejtë dhe efikas. Shembulli tipik vinte nga prefektura e Shkodrës. Në një telegram tepër urgjent për Ministrinë e Brendshme, më 19 korrik 1928, ajo njoftonte se

<sup>28</sup> *Po aty*, fl. 93, 96.

<sup>29</sup> *Po aty*, fl. 48.

kryeplaku i lagjes “Perash”, Lin Laca që ishte i vëllai i ish nëntogerit Gjush Laca, megjithëse ishte porositur të lajmëronte banorët e lagjes për të dalë në votime, nuk e kishte bërë këtë dhe nga 400 persona, në votime kishin marrë pjesë vetëm 20. Qëndrimi i tij cilësohej si pengesë për shprehjen e vullnetit popullor dhe kundërvënie ndaj qeverisë. Prandaj prefektura kërkonte autorizim që, po atë ditë, ky njeri të internohej në Gjirokastrë dhe pastaj do të bëheshin procedurat ligjore. Përgjigjja nga ministria erdhi po atë ditë, dhe urdhërohej që i përmenduri menjëherë të nisej në vendin e vuajtjes së dënimit, dhe pastaj të dërgoheshin formalitetet ligjore.<sup>30</sup> Pra, në funksion të arritjes së rezultatit të dëshiruar dhe për ta përdorur si shembull për të tjerët, që mund të mos zbatonin me korrektësi urdhrat e dhënë, vetë prefektura dhe aq më keq, Ministria e Brendshme shkelën ligjin, duke internuar një njeri, pa u shpallur fajtor nga gjykata.

Një hapësirë të veçantë, gjatë zhvillimit të procesit zgjedhor, morën lajmet apo hamendësimet e ndryshme, për persona apo grupe të caktuara, që mund të kishin tendenca për prishje të tij. Kujdes në këtë drejtim u kushtua sidomos për zonat veriore. Problematikat kryesore në këto vise parashikoheshin të vinin nga emigrantët politikë që ishin në Jugosllavi, të cilët mund të kalonin kufirin dhe të prishnin procesin. Duke ndier këtë rrezik, prefektura e Shkodrës bashkë me komandantin e qarkut atje, më 18 korrik 1928, kërkuan nga Ministria e Brendshme një autorizim që të dërgohej në ato vise një batalion ushtarësh, i cili do të bënte një patrullim duke filluar nga Kopliku, Shkreli, Boga, Qafa e Berdelecit, Thethi, rajoni i Dukagjinit dhe zona e Nikaj-Mërturit. Duke marrë parasysh shqetësimet dhe parandier rrezikun e mundshëm nga lëvizje të tilla, Ministria e Brendshme urdhëroi plotësimin dhe nisjen e batalionit në ato vise.<sup>31</sup> Dërgimi i këtij batalioni do të ishte në favor të politikës qeveritare për dy arsye kryesore: së pari, zvogëlonte mundësinë e ndërhyrjes së të arratisurve politikë në procesin zgjedhor dhe krijonte mbrojtje dhe siguri për zgjedhësit e dytë; së dyti, prania ushtarake në ato zona, demonstronte forcën e qeverisë dhe kjo në kuadrin e zhvillimit të zgjedhjeve, mund të shërbente edhe si mjet presioni për popullsinë, që të votonte zgjedhës të dytë pro kandidatëve qeveritarë.

<sup>30</sup> *Po aty*, fl. 71, 72.

<sup>31</sup> *Po aty*, fl. 63, 70, 98.

Udhëzimet e dhëna gjatë këtij procesi, duke qenë komunikime zyrtare mes organeve shtetërore, qendrore dhe lokale, dhe në shumicën e rasteve sekrete, ishin të panjohura për opinionin publik. Në këtë mosnjohje, ndikim të madh kishte mungesa e opozitës, e cila do të ishte e interesuara e drejtpërdrejtë për t'i zbuluar dhe bërë publike këto fakte. Pikërisht kuadri i gjerë i masave të marra nga qeveria dhe kontrolli rigoroz për zbatimin e tyre, ndikuan që zgjedhjet të kalonin pa shkaktuar ndonjë reagim publik dhe pa ndonjë bujë të madhe. Sipas gazetarit italian Gustavo Traglia, në këto zgjedhje nuk ndodhi ajo që rëndom shoqëronte ato në vendet e tjera: jo manifeste në mure, jo diskutime me ekspozimin e pikave të programeve të ndryshme, jo mbledhje, jo kontradikta. Vetëm një shënim, vetëm një karakteristikë, një konstatim permanent, “qetësia më absolute”.<sup>32</sup> Pavarësisht se udhëzimet dhe komunikimet sekrete midis institucioneve qendrore dhe lokale vazhdonin pa ndërprerje, autoritetet e larta shtetërore u përpoqën të demonstrojnë një mënyrë sjelljeje dhe qëndrimi larg procesit zgjedhor. E gjitha kjo ishte në funksion të transmetimit të idesë, se qeveria nuk po ndërhynte në zgjedhje dhe populli po shprehte lirish vullnetin e tij.

Me gjithë organizimin e bërë, urdhrat dhe mbështetjen e dhënë, pjesëmarrja e njerëzve në votime ishte e vogël. Arsye kryesore ishte mungesa e opozitës. Kjo ndikoi që ata që kishin mendim ndryshe, ose nuk ishin dakord me listën qeveritare, të mos kishin ndonjë interes të dilnin në votime. Kjo mangësi e zgjedhjeve, u trajtua nga organet e shtypit, disa prej tyre edhe pro qeveritare. Në fillim të gushtit 1928, gazeta “Zëri i Korçës”, duke trajtuar situatën në atë qark shkruante se, meqenëse për asamblenë, përveç kandidatëve qeveritarë dhe një ose dy të pavarur, nuk u shtuan të tjerë, nuk u pa ndonjë interes i madh në këto zgjedhje. Votat u hodhën të pakta sepse njerëzit mendonin se edhe me shumë, edhe me pak vota, ata kandidatë do të fitonin.<sup>33</sup> Shkrime të tilla u përdorën nga prefektura të veçanta, por për të tjera qëllime. Pikërisht për të justifikuar pjesëmarrjen e ulët të popullsisë në votime, që mund të cilësohej si dobësi e punës së tyre, ato u mbështetën fort te këto konstatime të shtypit, duke i akuzuar si ndikuese të drejtpërdrejta në këtë pjesëmarrje. Kështu prefektura e Shkodrës në një telegram që i dërgonte Ministrisë së Brendshme, më 23 korrik 1928, e njoftonte se, votuesit

<sup>32</sup> Gustavo Traglia, *L'Albania di Re Zog*, Roma: Edizioni Tiber, 1930, f. 23.

<sup>33</sup> “Zgjedhjet e Zgjedhësve të dytë”, në *Zëri i Korçës*, nr. 316, Korçë, 4 gusht 1928, f. 2.

shkodranë ishin duke ardhur në votime ngadalë, por mjaftueshëm. Si arsye e pjesëmarrjes së ulët paraqitej mungesa e partive kundërshtare. Por, për këtë nivel pjesëmarrjeje, ajo akuzonte edhe gazetën “Telegraf”, pasi me shkrimet e saj, i kishte dhënë të kuptonte popullit se, vetëm lista e kandidatëve të qeverisë kishte për t’u zgjedhur si asambleistë.<sup>34</sup> Pavarësisht synimit, këto relacione të prefekturave në vetvete ishin kontradiktore. Kjo pasi nga njëra anë, në disa raste, si shkak për numrin e ulët të zgjedhësve në votime, evidentonin pikërisht mungesën e opozitës, për të cilën vetë ato kishin përdorur të gjitha mjetet për ta minimizuar rolin dhe pjesëmarrjen e saj në zgjedhje. Nga ana tjetër, për të njëjtën gjë, akuzonin organet e shtypit.

Pavarësisht pjesëmarrjes së paktë të popullsisë në votime, numrit shumë të vogël të kandidatëve që nuk gëzonin mbështetjen qeveritare opozitës dhe problematikave të shfaqura, zgjedhjet u bënë. Nga masat e marra, mjetet e përdoruara, dhe kontrolli i ushtruar nga ana e organeve shtetërore, u arrit të sigurohej fitorja e plotë e kandidatëve qeveritarë. Në këtë mënyrë u siguroa një asamble besnike, e cila më 1 shtator 1928 shpalli Monarkinë Shqiptare dhe Ahmet Zogun “Mbret të shqiptarëve”, me emrin Zogu I.<sup>35</sup>

## Përfundime

Zgjedhjet për Asamblenë Kushtetuese të vitit 1928 dhe ndryshimi që erdhi nga ajo, ishin një risi për politikën shqiptare të kohës. Që nga parashikimi i procesit, deri në përfundim të tij, u vërejtën zhvillime interesante. Pavarësisht mjeteve të përdorura dhe qëllimit të demonstruar në publik, rruga e fillimit të këtij procesi u karakterizua nga elementë demokratikë. Kjo pasi hapat e hedhur që nga krijimi i konfliktit parlamentar, ndërrimi i qeverisë, shpërndarja e dhomave të parlamentit dhe dekretimi i zgjedhjeve për Asamblenë Kushtetuese, u bënë të mbështetura në ligj dhe brenda hapësirave kushtetuese. Pra në këtë rast A. Zogu veproi me zgjuars, pasi nëpërmjet rrugëve të mësipërme ligjëroi një proces, përfundimin e të cilit e kishte përcaktuar, pa e filluar akoma. Nëse fillimi i këtij procesi ishte i ligjësuar dhe u mbështet në elementë

<sup>34</sup> AQSH, F. 152, V. 1928, D.1, fl. 83.

<sup>35</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. III (Periudha e Pavarësisë 28 nëntor 1912 - 7 prill 1939), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2007, f. 228.

demokratikë, nuk mund të thuhet e njëjta gjë për ecurinë e tij. Pak nga pak elementët demokratikë u zhdukën gjatë zhvillimit të tij, ose edhe në rastet kur u vërejtën të tillë, ishin sipërfaqësorë dhe pa ndikim në ndryshimin e paracaktuar të rezultatit zgjedhor. Politika autoritare e shtetit u pasqyrua nga fillimi, deri në përfundim të zgjedhjeve. Organet shtetërore vendosën kontroll të plotë në të gjitha aspektet e procesit zgjedhor, duke dhënë urdhra të prera dhe duke ndërhyrë drejtpërdrejt për fitoren e kandidatëve qeveritarë. U penguan kandidatët rivalë, ose edhe kur u lejuan, veprimtaria e tyre u kontrollua dhe u kufizua, duke ua bërë të pamundur fitoren. U përdor propaganda dhe burimet financiare në mbështetje të kandidatëve qeveritarë. U ndaluan, burgosën, internuan kundërshtarë të caktuar, por edhe nëpunës shtetërorë, që neglizhuan në zbatimin e urdhrave. Në raste të caktuara u përdor xhandarmëria dhe ushtria. Pra, i gjithë procesi zgjedhor u ideua, u organizua dhe u zhvillua në funksion të fitores së kandidatëve përkrahës të Zogut, me qëllim sigurimin e një asambleje, e cila bëri ndryshimet e duhura kushtetuese, duke realizuar ëndrrën e tij për t'u kurorëzuar mbret.